



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2022:214324
Datë: 10.10.2024
Numri i dokumentit: 06279828

C.nr.3602/2022

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtarin Taulant Rexhëbeqaj, në çështje juridike kontestimore të paditësit: B.D. me numër personal nga fshati Brezne, komuna e Dragashit, të cilin me autorizim e përfaqëson Av. D.M. nga Prizreni, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Illyria” me seli në Prishtinë, me objekt kontesti: kompensim dëmi, vlera e kontestit 5,500.00 euro, jashtë seance, më datë 10.10.2024, mori këtë :

A K T G J Y K I M

-Në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpadia-

REFUZOHET në tërësi kërkesëpadia e paditësit B.D. nga fshati Brezne, komuna e Dragashit, *me të cilën ka kërkuar që të “ Aprovohet padia dhe kërkesë padia e paditësit B.D. nga fshati Brezne, komuna e Dragashit, në tërësi si e bazuar obligohet e paditura Kompania e Sigurimeve “Illyria” me seli në Prishtinë - që në emër të dëmit material dhe jo material për të gjitha format e dëmit të ia kompensoj shumën prej 5,500,00 euro, me kamat ligjore prej 8% nga dita e paraqitjes së padisë (dt.13.10.2022) e deri në pagesën përfundimtare nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm me përmbarrim, si dhe t’ia paguajë shpenzimet procedurale, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm me përmbarrim” . si e pabazuar.*

A r s y e t i m

Paditësi B.D. nga fshati Brezne, komuna e Dragashit, përmes të autorizuarit të tij, av D.M. nga Prizreni, me datën 18.10.2022, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi kundër të paditurës, Kompania e Sigurimeve “Illyria” me seli në Prishtinë, duke theksuar se me datë 30.09.2022, ka ndodhur aksident i komunikacionit, ku deri tek aksidenti ka ardhur si pasojë e lëshimeve të vozitësit “A”, i cili nuk respekton rregullat e komunikacionit dhe shkakton aksident me dëme materiale në automjetin “B” të tipit Opel Insigna” me targa të regjistrimit ngjyrë hiri, vitit i prodhimit 2027.

I autorizuar i paditësit me parashtrësën e datës 02.10.2024 dorëzuar në gjykatë më datë 07.10.2024, për heqjen dorë nga kërkesëpadia e njofton gjykatën se me të paditurën kanë

arritur marrëveshje jashtë gjyqësore dhe mbi këtë bazë nuk ka interes juridik për vazhdimin e ndjekjes së çështjes përmes Gjykatës, si dhe heq dorë nga kërkesëpadia.

Me nenin 3 par. 1 të LPK-së është paraparë se *“Palët mund të disponojnë lirisht me kërkesat juridiko – civile që i kanë parashtruar gjatë procedurës”*, ndërsa me par.2 të këtij neni është paraparë se *“Palët mund të heqin dorë nga kërkesat e tyre, ta njohin kërkesën e palës kundërshtare si dhe të bëjnë pajtim gjyqësor lidhur me kontestin e tyre”*.

Gjykata, pas heqjes dorë nga kërkesëpadia nga ana e paditësit, konstatoi se kërkesat janë të disponueshme për palët, edhe për kundër faktit se shqyrtimi kryesor në këtë çështje ka përfunduar me datë 02.07.2024, mirëpo duke marrë për bazë se nuk kemi të bëjmë me kërkesë me të cilën palët nuk kanë të drejtë të disponojnë lirisht siç parashihet me nenin 149.3 të LPK-së dhe se palët kanë arritur marrëveshje jashtëgjyqësore për këtë kontest. Gjykata konstaton se edhe në këtë fazë të procedurë mund të veprohet në kuptim të nenit 149, paragrafit 1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK-së) – me të cilin përcaktohet se *“në qoftë se paditësi deri në përfundimin e seancës për shqyrtim kryesor të çështjes heqë dorë nga një pjesë e kërkesëpadsisë apo nga e gjithë kërkesëpadia, gjykata pa shqyrtim të mëtejshëm e jep aktgjykimin me të cilin e refuzon kërkesëpadinë në pjesën nga e cila paditësi ka hequr dorë apo në tërësi (aktgjykimi në bazë të heqjes dorë)”*. Gjykata në bazë të lartcekurave vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga sa u tha më lartë, e bazuar në nenin 3 par. 1 dhe par. 2, lidhur me nenin 149 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.3602/2022, datë 10.10.2024

G j y q t a r i

Taulant Rexhëbeqaj

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate. Në kuptim të nenit 181, paragrafit 2 të LPK-së, ankesa mund të paraqitet vetëm për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore apo nga shkak se heqja dorë nga kërkesëpadia është dhënë në lajthitje apo nën ndikimin e dhunës apo mashtrimit.